



**GREEN Solution**

Tirana, Albania. Tel: +355 69 83 90 970

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE  
E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

**EMËRTIMI I PROJEKTIT:  
MENAXHIM I MBETJEVE KATALITIKE TË NGURTA DHE PJESËVE NGA PAJISJET  
ELEKTRONIKE.**

**VENDODHJA:  
PRANË KOMPLEKSIT "EURO MATI", SUPERSTARDA LEZHË - MILOT, KM 7,  
FSHATI GAJUSH, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNKOLL, BASHKIA LEZHË,  
QARKU LEZHË.**

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar,  
Menaxhimi i mbetjeve

Pika 5.5. Magazinim i hekurishteve, skrapeve te metalit qe nuk permbajne materiale te  
rrezikshme,

Pika 5.7. Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve te pajisjeve elektrike ose  
elektronike (WEEE),

Pika 5.10.a. Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme,

Pika 5.10.b. Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme.

Te gjitha instalimet Leje Mjedisi Tipi B.

**Kërkues:  
Subjekti: "INVEMET ALBANIA" SHPK**

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga Studio:  
**"GREEN Solution"**

Laert Shehu

Ekspert Mjedisi



Vanina Latifi

Eksperte Mjedisi

Shkurt, 2017

**TABELA:**

**STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT I VNM**

**Hyrje**

<b>1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR .....</b>	<b>4</b>
<b>2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....</b>	<b>5</b>
<b>3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ. ....</b>	<b>7</b>
<b>4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....</b>	<b>17</b>
<b>5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.....</b>	<b>18</b>
<b>6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....</b>	<b>19</b>
<b>7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.....</b>	<b>19</b>
<b>8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....</b>	<b>19</b>
<b>9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....</b>	<b>20</b>
<b>10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR. ....</b>	<b>20</b>

## HYRJE

Ky raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet me kërkesë të subjektit “INVEMET ALBANIA” SHPK, me numer NIPT-i: L37818501T, me seli në Lezhë Shënkoll GAJUSH Superstrada Lezhë – Milot, km 7, pranë Kompleksit “Euro Mati” dhe perfaqësues ligjor Z. Ferdinand Luca. Ky subjekt, ka paraqitur kërkesën për hartimin e procedurës së konsultimit me publikun pranë AKM dhe do të aplikojë pranë QKB-AKM për pajisjen me Leje Mjedisore të Tipit B për aktivitetin: Menaxhim i mbetjeve katalitike të ngurta dhe pjesëve nga pajisjet elektronike, Vendodhja: Pranë Kompleksit “Euro Mati”, Superstarda Lezhë - Milot, Km 7, Fshati Gajush, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë. (Sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Menaxhimi i mbetjeve, Pika 5.5. Magazinim i hekurishteve, skrapëve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme, Pika 5.7. Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike ose elektronike (WEEE), Pika 5.10.a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme, Pika 5.10.b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme. Të gjitha instalimet Leje Mjedisori Tipi B).

Objekti i vleresimit të këtij raporti është aktiviteti i grumbullimit, magazinimit, perpunimit dhe eksportimit të mbetjeve metalore me prejardhje nga automjetet e dala jashtë përdorimit, si dhe pajisjet elektronike e telefonike të dala jashtë përdorimit (katalizator, motorrina, dinam, akse, semiakse, skeda memorie ram, telefon, celular dhe pjesë të tjera materiale ku mund të kenë përberje të metaleve me vlerë). Nga mbetjet e grumbulluara bëhet një perpunim i pjesshëm me pajisjet e posaçme të instaluar ku bëhet ndarja e katalizatorit në pjesën metalike për skrap dhe qeramiken e brendshme. Me pas pjesa qeramike futet në një mulli bluares i cili përbehet nga një depozitë rrotulluese me sferë prej plumbi në brendësi të cilat kryejnë therrimin dhe bluarjen e qeramikes duke e shndërruar në pluhur të imet. Pluhuri paketohet në thasë sintetike me dopio shtresë të cilat nuk lejojnë depertimin e pluhurit jashtë tyre. Ky pluhur është produkti që eksportohet për në fabrikat e riciklimit.

Pjesa e katalitave shitet për skrap metal. Përveç katalitave subjekti kryen edhe grumbullimin e pjesëve metalike të cmontuara nga mjetet të cilat kanë përmbajtje të metaleve me vlerë. Këto pjesë i nënshtrohen vetëm procesit të seleksionimit dhe pasi paketohen dërgohen për riciklim.

Pjesët elektrike (qarqë të skedave të ndryshme të nxjerra nga pajisjet elektronike) grumbullohen nga prodhues të ndryshëm, magazinohen, ambalazhohen në kuti plastike dhe pas grumbullimit të një sasi të pershtatshme për transport eksportohen për në fabrikat e perpunimit, riciklimit ose asgjësimit.

Ky raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, parashikon ndikimet në mjedis që mund të shkaktojnë aktiviteti gjatë funksionimit të tij.

Bazuar në shtojcat I dhe II të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis”, ky aktivitet nuk përfshihet në listën e aktiviteteve që i nënshtrohen procedurës paraprake ose të thelluar të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis.

Vleresimi i Ndikimit në Mjedis, hartohet për të informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes së mjedisit mbi ndikimet në mjedis të aktivitetit.

### Ortofoto e vendodhjes se aktivitetit



Koordinatat e objektit ne sistemin Gaus-Kruger		
Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X
1	4389002.31	4620641.72
2	4389014.55	4620595.71
3	4389029.55	4620598.59
4	4389013.06	4620643.78



## 1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

### Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vleresojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimitet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet përberës të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

### Përshkrimi i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve të veçante dhe të rendesishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerezore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- **Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".**
- **Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".**
- **Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit".**
- **Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i ndryshuar.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit".**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Për menaxhimin e zhurmave".**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis".**
- **Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për zhvillimin e procedurave të VNM-se".**
- **Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore".**
- **Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave".**

## 2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Objekti ndodhet pranë kompleksit "Euro Mati", Superstrada Lezhe – Milot, Km 7, Fshati Gajush, Njesia Administrative Shenkoll, Bashkia Lezhe, Qarku Lezhe. Relievi eshte fushor. Bimesia e zones eshte kryesisht barishtore dhe pjeserisht pemtore (kryesisht pergjate kanaleve kullues dhe ne oborret e banesave dhe objekteve industriale). Ne zonen bregdetare identifikohen nje brez pishash te buta te mbjella ne menyre artificiale. Nje bimesi e tille verehet edhe ne shpatin malor te zones ne anen veriore te zones ne studim. Kjo siperfaqe e zhvillimit te aktivitetit, nuk ndodhet ne brendesi te zonave te mbrojtura dhe nuk prek specie bimore te rrezikuara apo te mbrojtura me ligj. Siperfaqja kufitare e Lagunes se Kune-Vain-Tale ndodhet rreth 4km ne veriperendim te siperfaqes se zhvillimit te aktivitetit.



### **Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit.**

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar një ligj mbi të cilin të mbeshtetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me



dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit" në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit "Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë" u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar "Mali i Dajtit" dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

### **Lagunat Bregdetare**

Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofrojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbledhet rreth 70% e llojeve të ruazorëve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përshkon të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug Velipojën, sistemin e Kune-Vainit, Patokun, Rrushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.

### **Rëndësia e Shqipërisë për llojet shtegtare**

Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakuriqve të natës dhe insekteve. Çdo vit takohen rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë totale prej 180.000 individësh në Shqipëri gjatë dimrit. 2 nga 9 llojet e shpendëve endemikë Europianë janë gjithashtu prezent në vendin tonë (Trishtili me mustaqe dhe Thëllëza e Malit). Gjithashtu 5 lloje të rrezikuara shpendësh takohen në Shqipëri si Pelikani kaçurel, Pata ballëbardhë, etj. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brëndësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë.

Së paku katër prej këtyre ligatinave (Laguna e Karavastasë, Laguna e Nartës, Liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si Zona të një Rëndësie Ndërkombëtare për shpendët, të njohura me emrin IBA (Important Bird Area), dhe plotësojnë kushtet për të qënë si zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20,000 mijë shpendë dimëronjës uji secila.

Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gëlqerorë dhe shpella, ofron varietete habitatesh që mund të përdoren si vende jetese për lakuriqët e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetura të lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tyelet e ndërtruara në kohët e shkuara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, janë vende të vlefshme për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës.


Një rast i veçantë është Shpella e Trenit që ndodhet në hyrje të Liqenit të Prespës së Vogël, dhe që është mbushur nga sedimentet e shkarkuara nga devijimi i Lumit Devoll këto 20-25

vjetët e fundit. Meqënëse kjo shpellë është bërë më e vogël dhe e tharë, ka humbur rëndësinë e saj për të bujtur koloni të vegjëlsh për disa lloje lakuriqësh, veçanërisht për *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii* dhe *Myotis daubentoni* dhe *Eptesicus serotinus*.

### 3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zhvillimit të këtij aktiviteti nuk ka burime ujore të identifikuar. Në afërsi të zones ndodhet Laguna e Kunes dhe të Vainit. Sipërfaqja në vlerësim ndodhet pranë kompleksit "Euro Mati", Superstrada Lezhë – Milot, Km 7, Fshati Gajush, Njesia Administrative Shenkoll, Bashkia Lezhe, Qarku Lezhe. Distanca nga pika më e afërt me vijën bregdetare është 3.4km në perëndim, distanca nga pika më e afërt me Lumin Mat është rreth 2.8km në jug dhe distanca nga pika më e afërt me Lagunen e Kunes dhe të Vainit është rreth 4km në veriperëndim.

#### Pozicionimi në lidhje me burimet ujore



#### Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive.

Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN.

Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive.



Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Zona në vlerësim nuk vlerësohet si zone me status të veçantë nga MM. Sic shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim ndodhet në distancë të konsiderueshme nga zonat e mbrojtura të rajonit të cilat citohen si më poshtë:

Në rajonin e Lezhës, Zona e Mbrojtur me e afert me projektin në vlerësim është Rezervati Natyror i Menaxhuar "Kune-Vain-Tale" i cili ndodhet rreth 4km larg aktivitetit në vlerësim.

#### **Rezervati Natyror i Menaxhuar "Kune-Vain-Tale" (Kategoria IV)**


Ndodhet në Qarkun e Lezhës dhe në rrethin e Lezhës. Sipërfaqja aktuale 4393.20 ha. Zonë e peizazhit tokësor dhe detar tërheqës. Mali i Rencit është zonë e një pylli të rrallë me dushkun *Quercus trojana*), por në gjëndje natyrore rritet edhe shega (*Punica granata*). Zonë me vlera të veçanta për zvarranikët dhe shpendët ujore e grabitqarë, ku veçojmë shqiponjën e malit (*Aquila chrysaetus*) dhe petritin (*Falco peregrinus*), lloje të rrallë që mbrohen nga disa konventa. Zonë e përfaqësuar nga pyll tipik mesdhetar. Megjithë ndryshimet që kanë ndodhur në të, zona ruan ende vlera të veçanta shkencore si zonë me një sërë tipe habitatesh, si IBA shumë e rëndësishme për shpendët migratore dhe në mënyrë të veçantë për koloninë e çapkave (fam. Ardeidae). Në këtë zonë takohet një pyll tipik mesdhetar, ndërsa në lagunën e Merxhanit dhe ligatinat përreth saj takohen lloje të shumtë shpende, për të cilat ajo ka fituar dhe statusin e një IBA. Laguna ka dhe vlera të veçanta iktike (peshqit). Zonë e pasur me vegjetacion ujor (të ujrave të njelmëta e të ëmbla) të shprehur mirë, me shtretër mjaft të shtrirë të kallamishteve të alternuar me pasqyra uji, mjaft e përshtatshme për shpendët e ujit dhe rrëmbenjësit e ditës (zona me densitetin më të lartë të këtyre të fundit në vëndin tonë). Grykëderdhja e Drinit ka rëndësi të veçantë për peshqit migratore. Ka plan menaxhimi.

Kufijtë e dixhitalizuar përfshijnë:


- a) Në Veri: Pika e ndërprerjes së kanalit me detin (4383844.25L/4629996.11V), ndjek argjinaturën deri në afërsi të Kënallës, kuota 1,6 m (4484996.74L/4630415.60V);
- b) Në Lindje: Kuota 1,6 m (4484996.74L/4630415.60V), ndjek kanalën kulluese dhe vijën ndarëse me tokat bujqësore, argjinaturën, kalon pranë hidrovorit deri te pika e takimit me lumin Drin (4383036.18L/4625364.06V);
- c) Në Jug: Pika e takimit me lumin Drin (4383036.18L/4625364.06V), vijon përgjatë lumit Drin deri te grykëderdhja në detin Ardiatik (4381327.00L/4625038.74V);
- d) Në Perëndim: Grykëderdhja në detin Ardiatik (4381327.00L/4625038.74V), ndjek vijën bregdetare të detit Adriatik deri në pikën e ndërprerjes me kanalën (4383844.25L/4629996.11V).



Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)







**Monumentet Natyrore te Rrethit Lezhe.(Sipas VKM 676)**

<b>Rera e Hedhur</b>	<b>Rivat e Drinit</b>
<b>Rrapi i Grykes</b>	<b>Keneta e Kashtes</b>
<b>Rrepet e Kolshit</b>	<b>Rivat e Drinit</b>
<b>Shpella e Hutit</b>	<b>Rrapi i Pirajave (Blinisht)</b>
<b>Shpella e Sukes se Vogel</b>	<b>Lisi i Markatomajt</b>
<b>Dritarja tektonike e Mirdites</b>	<b>Pylli (dushk, frasher, shkoze) i Shenmerise Kallmet (1 ha)</b>



MENAXHIM I MBETJEVE KATALITIKE TE NGURTA DHE PJESEVE NGA PAJISJET ELEKTRONIKE  
PRANË KOMPLEKSIT "EURO MATI", SUPERSTRADA LEZHË - MILOT, KM 7, FSHATI GAJUSH, NJËSIA  
ADMINISTRATIVE SHËNKOLL, BASHKIA LEZHË, QARKU LEZHË

RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI					VITI 2014-MARS		
MINISTRIA E MJEDISIT							
Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3.000,0
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.800,0
<b>KATEGORIA I Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)</b>					<b>SHUMA I</b>	<b>2</b>	<b>4.800,0</b>
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2.630,0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.280,0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.010,0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.380,0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8.000,0
9	II	Durrës	Krujë	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2.000,0
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjoçaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140,0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27.750,0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9.424,4
13	II	Tiranë,Durrës		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29.216,9
		Tiranë	Tiranë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26.772,7
		Durrës	Krujë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2.444,2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22.230,2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavaste	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19.411,1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavaste	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2.074,5
		Tiranë	Kavajë	Divjakë-Karavaste	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744,6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33.927,7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33.760,1
		Diber, Kukës	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167,6
16	II	Gjirokastrë, Korçe		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	1	34.361,1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		33.165,3
		Korçe	Kolonje	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		1.195,8
17	II	Vlorë	Vlorë	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, datë 28.04.2010	1	12.428,0
		Berat, Elbasan		Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24.723,1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8.398,4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15.045,8
		Elbasan	Grahsh	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1.278,9
<b>KATEGORIA II Park Kombetar - Kategoria II (PK)</b>					<b>SHUMA II</b>	<b>15</b>	<b>210.601,4</b>
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	348	0,0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	398	0,0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0,0
21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.740,0
22		Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.500,0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syni i Kaltër	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	180,0
24	III	Dibër	Dibër	Vlshaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	50,0
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0,0
				Totali MonNatyre Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	750	0,0
<b>KATEGORIA III Monument Natyre - Kategoria III (MN)</b>					<b>SHUMA III</b>		<b>3.470,0</b>
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20.000,0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250,0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330,0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafilak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250,0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kulturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3.600,0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1.500,0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880,0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200,0
33	IV	Berat	Berat	Balloj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330,0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500,0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2, datë 26.12.1995	1	650,0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrezomë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.400,0
37	IV	Kukës	Hes	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	30,0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelequr	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	430,0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	45,0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400,0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	300,0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400,0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodrës	VKM nr. 684, datë 02.11.2005	1	26.535,0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vaim-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4.393,2
45	IV	Lezhë	Kurbini	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5.000,7
46	IV	Diber, Kukës		Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011	1	55.550,2
		Diber	Diber	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		20.663,4
		Kukës	Kukës	Korab-Koritnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		34.886,8
<b>IV/1 Park Natyror Rajonal</b>							
47	IV/1	Diber	Mat	Liqeni i Ultez dhe zona perreth tij	VKQ nr. 16, datë 03.04.2013	1	4.206,0
<b>KATEGORIA IV Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)</b>					<b>SHUMA IV</b>	<b>23</b>	<b>127.180,1</b>
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	510,0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27.323,0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680, datë 22.10.2004	1	19.738,0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682, datë 02.11.2005	1	23.027,0



MENAXHIM I MBETJEVE KATALITIKE TE NGURTA DHE PJESEVE NGA PAJISJET ELEKTRONIKE  
PRANË KOMPLEKSIT "EURO MATI", SUPERSTRADA LEZHË - MILOT, KM 7, FSHATI GAJUSH, NJËSIA  
ADMINISTRATIVE SHËNKOLL, BASHKIA LEZHË, QARKU LEZHË

52	V	Tiranë, Diber, Elbasan		M. Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr. 49, datë 31.01.2007	1	25,266.4	
		Tirane	Tirane	M. Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr. 49, datë 31.01.2007		13,213.6	
		Diber	Mat	M. Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr. 49, datë 31.01.2007		3,016.7	
		Diber	Bulqize	M. Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr. 49, datë 31.01.2007		9,036.1	
	KATEGORIA V	Peizazh I Mbrojtur - Kategoria V (PM)			SHUMA V	5	95,864.4	
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr. 102, datë 15.01.1996	1	5,900.0	
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr. 102, datë 15.01.1996	1	5,400.0	
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr. 102, datë 15.01.1996	1	4,745.0	
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr. 102, datë 15.01.1996	1	2,200.0	
	KATEGORIA VI	Zone e Mbrojtur e Burimeve të Natyrore të Menaxhuara - Kategoria VI (ZMBNM)			SHUMA VI	4	18,245.0	
	TOTALI i ZM					16%	799	460,060.9

Sip. Republikës	2,874,800.00	ZM pa Sip. Detare	15.64%	446,799.7
		Sip. Detare, Ha	0.5%	13,261.2
		Karaburun-Sazan		12,428.0
		Butrint		833.2
		Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95%
				119,401.6

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit të Ministrave			
b	VKQ	Vendim i Keshillit të Qarkut			
c	MB	Ministria e Bujqësisë			
d	ZM	Zone e Mbrojtur			

LISTA E ZONAVE RAMSAR

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Leguna Kërvastase_Pisha Divjakes	VKM nr. 413, datë 22.08.1994	Nr. Site 781, dt. 29.11.1995	20,000.0	
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukës-Butrint-Kepi Stillos	VKM nr. 531, datë 31.10.2002	Nr. Site 1290, dt. 28.3.2003	13,500.0	
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liçeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr. 683, datë 02.11.2005	Nr. Site 1598, dt. 2.2.2006	49,562.0	
4	RAMSAR	Korce	Korce, Devoll	Liçeni i Prespave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr. Site 2151, dt. 03.07.2013	15,118.6	
	TOTALI					%/Totalit Republikës	3.42%	98,180.6

DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONAT E MBROJTURA  
SEKTORI I ZONAVE TË MBROJTURA  
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.  
[www.mjedisi.gov.al/](http://www.mjedisi.gov.al/)

## Mjedisi social-ekonomik

### Popullsia

Sipas CENCUS 2011, popullsia e Shqipërisë është 2.8 milion banorë me një rënie prej 8% në dy dekadat e fundit. Gjatë periudhës 2001-2013, në Shqipëri, popullsia banuese është reduktuar në 10 qarqe dhe ka shënuar rritje vetëm në dy qarqe. Rënia e popullsisë përgjatë kësaj periudhe në të gjithë vendin ka qenë 8.2 për qind, por në Gjirokastrë popullsia ka rënë me 35.7 për qind ndërsa në Tiranë është rritur me 26.1 për qind. Në vitin 2013, qarku me popullsinë më të vogël ishte Gjirokastra me afërsisht 68 mijë banorë ndërsa qarku me popullsinë më të madhe ishte Tirana me 766 mijë banorë.

### Ujërat, Gjëndja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Monitorimi i ndotjes së UN gjatë vitit 2013 është kryer në 7 basenet ujembajtëse për akuiferet e zhavoreve kuaternare: - Shkodër, Lezhë-F.Kuqe, Tiranë- F.Kruje, Elbasan-Lushnje, Korçë, Gjirokastrë-Kafaraj-Novoselë, Vurg-Mursi e Orikum. Këtë vit u monitoruan 6 burime kryesore të akuiferit karbonatik: në basenin e Drinit burimi Syri i Sheganit, burimi Tushemisht, burimi i linit, në basenin e semanit burimi i Mancurishtit, në basenin e zonës Jonike burimi Syri i Kaltër dhe burimi Uji i Ftohte Vlorë.

Të dhënat e marra janë paraqitur për çdo akuifer të basenit. Janë vlerësuar e krahasuar përmbajtjet e treguesve ndotës si NO<sub>2</sub>, NO<sub>3</sub>, NH<sub>4</sub> dhe treguesve të tjerë Na, Ca, Mg, Fe, Cl, SO<sub>4</sub>, Fp, pH, Mp, me standartet e vendit dhe të Bashkimit Europian. Janë krahasuar me standartet e Shqipërisë përmbajtja e rekomanduar (STASH- R) dhe përmbajtja maksimale e lejuar ( STASH PML). Gjithashtu vlerat e treguesve të monitoruar janë krahasuar me normat e Bashkimit Europian, përmbajtja e rekomanduar( BE-R) dhe përmbajtja maksimale e lejuar (BE-PML).

## **Baseni i Matit**

Nga Ministria e Mjedisit janë monitoruar akuiferi ujëmbajtëse zhavoror i Lezhës dhe i Fushë-Kuqes

Akuiferi ujëmbajtës zhavoror i Lezhës

Koeficienti i shfrytëzimit është:  $K = 0.3-0.35$

Risku i ndotjes sipërfaqësore është i ulët falë mbulesës së trashë ekranizuese, largësisë së zonës së ushqimit dhe karakterit artezian të shtresave ujëmbajtëse. Vetëm intensiti kimik i madh i shfrytëzimit mund të nxisë depërtimin e ujrave me mineralizim të lartë nga krahu verior e perëndimor i pellgut ujëmbajtës.

T-Temperatura e ujit në dy fazat e monitorimit varion  $T = 14.5-16.4$  gradë Celsius, tregues brenda normës (norma 8-15, deri 20).

pH i ujërave nëntokësore në dy fazat e monitorimit varion 8.2-9.11, ndërsa në dy fazat e monitorimit në vitin 2012 varion 8.17-9.53. Sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është në kufi rin e lejuar deri pak mbi normë, por nën vlerën maksimale të lejuar (9.50). Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 8.37-8.89

**Fp-** Fortësia e përgjithshme në dy fazat e monitorimit të vitit 2013 varion  $Fp=0.84-3.640$  gjermane në shpimet nr.29 I.Lezhë, nr.50 Barbulloje, nr.46 I.Lezhë. Në vitin 2012 fortësia e përgjithshme varion  $Fp=1.62-4.2$  Gjermane. Uji është shumë i butë dhe nën vlerën e rekomandur. Në vite nuk ka tendencë rritje të Fp por vetëm luhatje stinore

**Mp-** Mineralizimi i përgjithshëm në dy fazat e monitorimit të vitit 2013 varion  $Mp=328.35-721.57$  mg/l në  $Mp=443.58-716.75$  mg/l janë brenda normës së lejuar. Ndryshimet e Mp në dy fazat e monitorimit janë të vogla, vihet re ulje e Mp në fazën e dytë të monitorimit, ato variojnë 14.5- 62.9-96.5 mg/l. Vlera mesatare 5 vjecare e Mp varion  $Mp=572.92-996.57$  m

**Mth-** Mbetja e thatë në dy fazat e monitorimit varion  $Mth= 261-579$  mg/l. Ndërsa në vitin e kaluar varionte  $Mth= 363-626$  mg/l, Përmbajtje brenda normës së lejuar ( 5000-1000mg/l). Në shpimin nr.2s Rrile, mbetja e thatë është  $Mth=2593-2616$  mg/l, në vitin 2012 është  $Mth=2512$  mg/l, mbetja e thatë është mbi normë.

**Na-** Përmbajtja e Natriumit Na në dy fazat e monitorimit varion nga 101.89-215.97 mg/l në shpimin nr.29 I.Lezhë, nr.46 H.Gjuetisë, nr.50 Barbullonjë. Në vitin 2012 në dy fazat e monitorimit në shpimin nr.29 I.Lezhë, nr.46 H.Gjuetisë, nr.50 Barbullonje përmbajtja Natriumit është 132.94- 212.52 mg/l. Në shpimin nr.2s Rrile përmbajtja e Na varion 785.91-798.79 mg/l, ndërsa në vitin 2012 përmbajtja e Na varion 772.8-774.87 mg/l. Përmbajtja mesatare e Na në shpimin nr.2s është 750.58mg/l. Përmbajtja e Na është mbi standartin e rekomanduar dhe PML në shpimin nr.2s, nr.46 e nr.50.

**Ca-** Përmbajtja e Kalciumit Ca në dy fazat e monitorimit varion nga 2-10.02 mg/l në shpimet nr. 46 H.Gjuetisë, nr.50 Barbullonje, nr.29 I.Lezhe. Përmbajtja e Kalciumit Ca në dy fazat e monitorimit të vitit 2012 varion nga 3.01-8.02 mg/l. Përmbajtje e ulët është refl ektuar në fortësinë përgjithshme e cila është e vogël në këto shpime. Ndryshimet e Ca në dy fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 0-0.07 deri 4.01mg/l. Përmbajtja mesatare në vite e Ca është 6.61-10.72 mg/l

**Mg-** Përmbajtja e Magnezit Mg në dy fazat e monitorimit varion nga 1.22-10.94 mg/l. Në vitin 2012 përmbajtja e Magnezit varion nga 3.65-13.38 mg/l, Kjo përmbajtje e ulët e Mg është refl ektuar në fortësinë e përgjithshme të ulet në këto shpime. Në shpimin nr.2s Rrile, përmbajtja e Mg në dy fazat e monitorimit është 63.23-67.49 mg/l, ndërsa në vitin e kaluar është 62.02-65.66 mg/l, përmbajtje kjo mbi PML. Ndryshimet e Mg në dy fazat e monitorimit

janë të vogla, ato variojnë 0-1.21-2.73 mg/l deri në 4.26 mg/l përmbajtja mesatare është 60.76 mg/l, është mbi normë

**Fe-** Përmbajtja e Hekurit Fe në dy fazat e monitorimit varion nga 0.01-0.13 mg/l, në vitin 2012 ky tregues varion 0.01-0.79 mg/l. Takohet përmbajtje mbi normën rekomanduar dhe përmbajtjen maksimale të lejuar PML në shpimin nr. 2s Rrile në analizën e fazës së parë të vitit 2012 dhe në fazën e parë të vitit 2013. Ndryshimet në dy fazat e monitorimit variojnë 0.01-0.02-0.12 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 0.052-0.137 mg/l.

**NH4-** Përmbajtje amonjaku NH4 takohet në fazën e parë të monitorimit në shpimet nr.50 në sasinë 0.05 mg/l dhe nr.46 në sasinë 0.05mg/l. Nuk takohet përmbajtje amonjaku NH4 në shpimin nr.2s Rrile e nr.29 I.Lezhe. Përmbajtje amonjaku në fazën e dytë të monitorimit takohet në sasinë 0.28 mg/l në shpimin nr.50 Barbullonjë, në sasinë 0.09 mg/l në shpimin nr.29 I.Lezhë. Përmbajtje mesatare në vite e Amonjakut varion 0.002-0.088mg/l.

**Cl-** Përmbajtja e Klorit Cl në dy fazat e monitorimit varion nga 47.93-92.3 mg/l në shpimin nr.29 I.Lezhe st. Shëngjinit (në vitin 2012 varion 90.53-97.63mg/l ). Në shpimet nr.46 e 50 përmbajtja e Cl varion 211.23-232.53 mg/l, në vitin 2012 përmbajtja e klorit Cl varion 221.88-236.08 mg/l. Përmbajtja mesatare në vite varion 157.62-226.66mg/l.

**SO4 -** Përmbajtja e Sulfateve SO4 në dy fazat e monitorimit varion nga 17.69-48.15 mg/l në shpimet nr. 46 H.Gjuetisë, nr.50 Barbullonjë, nr. 29 I.Lezhë, Përmbajtja e Sulfateve SO4 në vitin 2012 në këtë shpim varion nga 18.93-53.08 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 29.87-313.81 mg/l.

**NO3-** Përmbajtja e Nitrateve NO3, në dy fazat e monitorimit është e vogël, ajo varion nga 0.08- 1.06 mg/l, ndërsa në vitin 2012 ajo varionte 0.17-2.6 mg/l.Përmbajtja e Nitrateve eshte Brenda normes . Ndryshimet ne dy fazat e monitorimit jane te vogla qe variojne 0.0-0.51 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare eshte e vogel, ajo varion 0.37-0.69 mg/l.

**NO2-** - Përmbajtja e nitriteve ne fazen e pare te monitorimit takohet në Barbullonje në sasinë 0.04 mg/l, në H.Gjuetisë në sasinë 0.01mg/l. Nuk takohet përmbajtje e nitriteve në Rrile e I.Lezhë. Përmbajtja e Nitriteve në fazën e dytë takohet në sasinë 0.01 mg/l, në shpimet nr. 29. I.Lezhe, nr.46 H.Gjuetise, në shpimin nr.50 Barbullojë, sasi kjo brenda normës së lejuar. Përmbajtja mesatare 5-vjecare e Nitriteve varion 0.01-0.69 mg/l.

Akuiferi ujëmbajtës zhavoror i Fushë-Kuqes ( Laçit )

Sasia e ujit që shfrytëzohet është 1250-1300 l/sek për furnizimin e qyteteve të Durrësit, Laçit, Milotit, Mamurrasit dhe rrethf shatrave të zonës deri në Durrës. Është akuiferi ujëmbajtës meshfrytëzim më intensiv dhe me perspektivë për rritje rezervash të UN. Koefi centi i shfrytëzimit është: K = 0.35-0.5

**T -** Temperaturë e ujit në dy fazat e monitorimit është T= 12.9-17.5 gradë Celsius, temperature mesatare është T=15.71 Ocelsius ( norma 8-15, deri 20).

**pH** i UN në dy fazat e monitorimit varion 7.83-8.58, ndërsa në vitin 2012 vlerat e tij variojnë pH=7.73-8.85. Sipas normës se lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës (Ph = 6,5-8,5). Vlerat mesatare të pH për vitet 2009-2013 variojnë 7.88-8.41.

**Fp -** Fortësia e Përgjithshme në dy fazat e monitorimit varion Fp=7.98-1120gjermane dhe në vitin 2012 varion Fp=8.26-15.12 Ogjermane. Ky tregues është brenda normës së lejuar, uji është me fortësi mesatare. Ndryshimet e Fp në dy fazat e monitorimit janë të vogla që variojnë 0.28-0.66- 2.38 Ogjermane. Vlerat mesatare 5 vjecare 8.47-13.49 0 gjermane

**Mp -** Mineralizimi i përgjithshëm në dy fazat e monitorimit varion Mp=223.32-386.04 mg/l, në vitin e kaluar varion Mp=242.2-455mg/l. Mp varion 1186.31-1218.21 mg/l . Ndryshimet e



Mp në dy fazat e monitorimit variojnë nga 8-53 mg/l. Mineralizimi i përgjithshëm mesatar 5 vjecar varion  $Mp=2493.7-397.4$  mg/l.

**Na** - Përmbajtja e Natriumit në dy fazat e monitorimit varion nga 2.07-19.09 mg/l. Në shpimin nr.177 Patok përmbajtja e Na është 345-351.21mg/l. Në vitin 2012 përmbajtja e Natriumit varion nga 8.05-27.14 mg/l. Në shpimin nr.177 Patok përmbajtja e Na është 353.97-364.32mg/l PML. Përmbajtja mesatare varion 9.98-20.04 mg/l.

**Ca** -Përmbajtja e Kalciumit në dy fazat e monitorimit varion nga 18.04-49.1mg/l, në vitin 2012 përmbajtja e Ca varionte 14.49-42.08 mg/l. Kjo përmbajtje është brenda përmbajtjes së rekomanduar. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 18.73-49.1 mg/l.

**Mg** -Përmbajtja e Magnezit Mg varion nga 20.67-38.91 mg/l. Në vitin e kaluar ajo varionte 20.04-38.08 mg/l. Përmbajtja është brenda standartit dhe PML. Ndryshimet e Mg në dy fazat e monitorimit variojnë 3.7-9.7 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 23.1-34.96 mg/l.

**Fe** -Përmbajtja e Hekurit Fe në dy fazat e monitorimit varion nga 0.04-0.08 mg/l. Takohet përmbajtje mbi normën e rekomanduar deri nën përmbajtjen maksimale të lejuar PML në fazën e parë gjithë shpimet dhe në fazën e dytë në shpimin nr.197.Gurrëz. Ndryshimet e Fe në dy fazat e monitorimit variojnë 0-0.02-0.04 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 0.04-0.052 mg/l.

**NH4**- Në fazën e parë të monitorimit nuk takohet përmbajtje amonjaku NH4. Në fazën e dytë të monitorimit takohet përmbajtje amonjaku NH4 në Patok në sasinë 0.02mg/l, përmbajtje Brenda kufi rit maksimal të lejuar. Në fushë-Kuqe, Gurrëz, Milot dhe Lac takohet përmbajtje në sasinë 0.01 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 00.002-0.024mg/l.

**Cl** -Përmbajtja e Klorit Cl në dy fazat e monitorimit varion nga 5.33-30.18 mg/l F.Kuqe, Lac, Gurrëz, Milot. Përmbajtje është pak mbi STASH të rekomanduar, por nën përmbajtjen maksimale të lejuar. Në Patok që shfrytëzon horizontin e dytë ujëmbajtës përmbajtja e Cl në dy fazat e monitorimit varion 536.05-548.48 mg/l. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 9.94-27.51 mg/l

**SO4** -Përmbajtja e Sulfateve SO4 në dy fazat e monitorimit varion nga 13.58-69.96 mg/l. Në vitin 2013 përmbajtja e sulfateve ka variuar 20.16-74.07mg/l në shpimet nr.177 Patok, nr.26 F.Kuqe, nr.197 Gurrëz, nr.176 Milot e nr.509 Lac, përmbajtje kjo brenda standartit. Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 20.9-62.26 mg/l

**NO3**- Përmbajtja e Nitrateve NO3, në dy fazat e monitorimit është e vogël, ajo varion nga 0.49- 6.23 mg/l. . Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 0.78-3.51 mg/l.

**NO2**- Nuk takohet përmbajtja e Nitriteve NO2: në fazën e parë të monitorimit. Në fazën e dytë takohet përmbajtje e nitriteve në gjithë shpimet e monitorimit sasi kjo brenda kufi rit maksimal të lejuar (kufi ri max i lejuar 0.05mg/l). Përmbajtja mesatare 5 vjecare varion 0.002-0.033 mg/l.

**O2**- varion 0.74-5.85mg/l përmbajtja është më e vogël se norma.

Analiza për mikroelemente - Analizat për mikroelemente është marrë në shpimin nr.26 Fushë- Kuqe për Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr.Cd. Në këto analiza ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni=0.002-0.001 mg/l, Mn=0.001-0.006 mg/l, Zn=0.009-0.004mg/l, Pb=0.011-0.04mg/l, Cu=0.005- 0.001mg/l, Co=0.03-0.003mg/l, Cr=0.014-0 mg/l, Cd=0-0.001. Përmbajtja e mikroelementeve është në përmbajtjen e rekomanduar deri në PML.

*Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2013, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit(Faqja Zyrtare).*

#### **4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.**

##### **Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)**

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis" dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

##### **Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.**

###### **Shkarkime ne uje**

Nuk ka ndotje ne ujerat siperfaqesore dhe nentokesore, per vete faktin se proceset e ketij aktiviteti kryhen ne ambjent te thate.

###### **Emetimet ne ajer**

Emetime ne ajer krijohen vetem gjate procesit te perpunimit te katalitave, duke u krijuar grimca ne ajer, por ne nje sasi te pakonsiderueshme. Thithja e pluhurave nga makineria e perpunimit te mbetjeve te katalitave eshte realizuar me sistem filtrimi. Shkarkimet ne ajer jane te pakonsiderueshme. Per vete pozicionin qe ka objekti, pluhurat nuk arrijne deri ne ambjentet e fqinjeve. Mjedisit i punes eshte i mbyllur dhe me sistem te kapjes se pluhurave.

### **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurma e prodhuar vjen kryesisht nga mulliri bluaries. Ne fillim te procesit te bluarjes se copezave katalitike, niveli i zhurmes eshte i larte per shkak te kontaktit qe kane sferat e plumbit me kazanin e mullirit, me pas kjo zhurme vjen duke u zvogeluar. Punëtorët që ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Nuk shkaktohen vibrime. Objekti ndodhet ne nje distance te larget me banesat.

### **Ndikimi ne toke**

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke. Ambjenti ne te cilin kryhet puna eshte i shtruar dhe nuk ka kontakt me mjedisin tokesor. Nuk ka filtrim te ujerave siperfaqesore ne toke.

### **Ndikimi ne Biodiversitet**

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitetin e mjedisit tokesor.

### **Ndikimi ne Mjedisin Social**

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit qe ofron, konkurrences ne treg dhe uljes se cmimeve. Efekti negativ i vetem eshte ne rastet e shkarkimit te pluhurit gjate procesit te perpunimit te katalitave dhe clirimi i zhurmes ne mjedisin e zones. Per te shmangur keto efekte, subjekti duhet te mos punoje gjate oreve te vona dhe te perdore mjete silencioze per prerjen dhe perpunimin e katalitave. Punonjesit ne mjediset e punes duhet te perdorin kufje per veshet nese do te shohin te arsyeshme perdorimin e tyre.

### **Mbetjet e prodhuara**

Pjesa e katalitave shitet per skrap metali. Pervec katalitave subjekti kryen edhe grumbullimin e pjeseve metalike te cmontuara nga mjetet te cilat kane permbajtje te metaleve me vlere. Keto pjese i nenshtrohen vetem procesit te seleksionimit dhe pasi paketohen dergohen per riciklim. Pjeset elektrike (qarqe te skedave te ndryshme te nxjerra nga pajisjet elektronike) grumbullohen nga prodhues te ndryshem, magazinohen, ambalazhohen ne kuti plastike dhe pas grumbullimit te nje sasi te pershtatshme per transport eksportohen per ne fabrikat e perpunimit, riciklimit ose asgjесimit.

## **5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.**

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Nuk ka ndotje ne ujerat siperfaqesore dhe nentokesore, per vete faktin se proceset e ketij aktiviteti kryhen ne ambjent te thate.

Emetime ne ajer krijohen vetem gjate procesit te perpunimit te katalitave, duke u krijuar grimca ne ajer, por ne nje sasi te pakonsiderueshme. Thithja e pluhurave nga makineria e perpunimit te mbetjeve te katalitave eshte realizuar me sistem filtrimi. Shkarkimet ne ajer jane te pakonsiderueshme. Per vete pozicionin qe ka objekti, pluhurat nuk arrijne deri ne ambjentet e fqinjeve. Mjedisi i punes eshte i mbyllur dhe me sistem te kapjes se pluhurave.

Zhurma e prodhuar vjen kryesisht nga mulliri bluaries. Ne fillim te procesit te bluarjes se copezave katalitike, niveli i zhurmes eshte i larte per shkak te kontaktit qe kane sferat e plumbit me kazanin e mullirit, me pas kjo zhurme vjen duke u zvogeluar. Punëtorët që

ndodhen në mjedisë ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e degjimit (Kufje ose tapa për veshet). Nuk shkaktohen vibrime. Objekti ndodhet në një distancë të largët me banesat.

Proceset e punës nuk ndikojnë në tokë. Ambjenti në të cilin kryhet puna është i shtruar dhe nuk ka kontakt me mjedisin tokësor. Nuk ka filtrim të ujërave sipërfaqësore në tokë.

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e ndjeshme të zonave të mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon në biodiversitetin e mjedisit tokësor.

Ndikimi i këtij aktiviteti në mjedisin social, është pozitiv përse i përket punësimit, shërbimit që ofron, konkurrencës në treg dhe uljes së çmimeve. Efekti negativ i vetëm është në rastet e shkarkimit të pluhurit gjatë procesit të përpunimit të katalitave dhe çirimit i zhurmës në mjedisin e zonës. Për të shmangur këto efekte, subjekti duhet të mos punojë gjatë orëve të vona dhe të përdorë mjete silencioze për prerjen dhe përpunimin e katalitave. Punojësit në mjediset e punës duhet të përdorin kufje për veshet nëse do të shohin të arsyeshme përdorimin e tyre.

Pjesa e katalitave shitet për skrap metal. Përveç katalitave subjekti kryen edhe grumbullimin e pjesëve metalike të çmontuara nga mjetet të cilat kanë përmbajtje të metaleve me vlerë. Këto pjesë i nënshtrohen vetëm procesit të seleksionimit dhe pasi paketohen dërgohen për riciklim. Pjesët elektrike (qarqë të skedave të ndryshme të nxjerra nga pajisjet elektronike) grumbullohen nga prodhues të ndryshëm, magazinohen, ambalazhohen në kuti plastike dhe pas grumbullimit të një sasi të përshtatshme për transport eksportohen për në fabrikat e përpunimit, riciklimit ose asgjësimit.

## **6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.**

Ndikimi i aktivitetit në kushte normale funksionimi do të zgjase për aq kohë sa zgjat edhe aktiviteti (nga ora 07:00-17:00). Ndikimi në mjedis zgjat për aq orë sa funksionon aktiviteti në ditë dhe aq ditë sa ai funksionon në një vit.

## **7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS**

Ndikimi në mjedisin e zonës në kushte normale të punës, mund të përhapet në një distancë me dhjetëra metra, ose deri në 100m, kjo përse i përket ndikimit të zhurmës. Shkarkime në ujëra nuk ka.

## **8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.**

Subjekti investitor, duhet të kujdeset për një mjedis të pastër, të rregullt, të gjelberuar dhe të pajisur me sinjalistikën dhe posterat sensibilizues përkatës për kushtet teknike dhe për mjedisin. Në rast të mbylljes apo ndryshimit të vendodhjes së instalimit, ky mjedis të rehabilitohet plotësisht dhe të shënderrohet në një mjedis të pastër e të këndshëm.



## **9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.**

- Punëtorët që ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e degjimit (Kufje ose tapa për veshet).
- Te gjitha mbetjet e ngurta që prodhohen duhet të menaxhohen në bashkëpunim me subjekte të licencuara për menaxhimin e tyre.
- Punonjësit të zbatojnë rregullat dhe kushtet teknike gjatë punës.
- Ambjenti i punës të jetë gjithmone i ajrosur.
- Punonjësit të punojnë gjithmone nën mbikqyrjen e Drejtuesit teknik, në mënyrë që të kenë siguri të kushteve teknike të punës së tyre.

## **10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).**

Ky aktivitet nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmim të mjedisit nderkufitar. Aktiviteti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të shteteve fqinje, madje në kushte normale, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.